

20151734803

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE
INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15 dhe 97/15), në nenin 102 paragrafi (2) fjalët: "fëmijë me hendikep më të rëndë" zëvendësohen me fjalët: "fëmijë me pengesa mentale ose trupore në zhvillim".

Neni 2

(1) Dispozitat e nenit 37 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15 dhe 97/15) nuk do të zbatohen në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2016.

(2) Në vitin 2016 të gjitha llojet e pensioneve në pajtim me këtë ligj harmonizohen në mënyrë që shumta e përgjithshme për pagesën e pensioneve për shtator 2016 rritet për 5% dhe pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të shfrytëzuesve të pensionit të cilët pensionin e kanë realizuar përfundimisht me shtatorin e vitit 2016.

Neni 3

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa dispozitat e nenit 2 paragrafi (2) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 tetori 2016.